REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 qershor 2022
Nr. ref.:AGJ 2004/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI55/21

Parashtrues

Muhamet Ademi

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 387/2020 të 13 janarit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamet Ademi, me vendbanim në Podujevë, të cilin e përfaqëson Xhavit Bici, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr. 397/2020] të 13 janarit 2021 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës [Pr. nr. 725/2016] të 16 prillit 2020 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 mars 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), pranoi kërkesën e parashtruesit, i cili e dorëzoi atë përmes postës më 16 mars 2021.

6. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama – Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu Krasniqi.

7. Më 26 mars 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë: (i) autorizimin për përfaqësim në Gjykatë, i (ii) kopjet e vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta.

8. Më 4 prill 2021, përfaqësuesi ligjor dorëzoi autorizimin për përfaqësim dhe dokumentet e kërkuara nga Gjykata.

9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas

përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KI55/21, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.

12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 të 17 majit 2021, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

13. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, me vendimin KSH. KI55/21, caktoi gjyqtarin Radomir Laban anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të Arta Rama-Hajrizi, mandati i së cilës si gjyqtare ka përfunduar më 26 qershor 2021.

14. Më 20 tetor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

15. Më 20 tetor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që t'ia dorëzojë Gjykatës dosjen e plotë të lëndës së vendimit të kontestuar.

16. Më 27 tetor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan i dorëzoi Gjykatës shkresat e plota të lëndës të vendimit të kontestuar.

17. Më 10 mars 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e pranueshme dhe se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2020], i 13 janarit 2021, nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

18. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar si Zyrtar Korrektues në Shërbimin Korrektues, Qendra e Paraburgimit në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi).

19. Më 26 qershor 2004, punëdhënësi mori vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të kundërvajtjes disiplinore gjatë orarit të

punës të përcaktuar me Kodin e Brendshëm të Disiplinës së Shërbimit Korrektues. Në njoftimin për ndërprerjen e punës nga punëdhënësi saktësohej se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte rezultat i një incidenti të ndodhur më 21/22.05.2004, ku ka ndodhur arratisja e një të burgosuri dhe tentativa për arratisje e tre të burgosurve të tjerë, dhe konsiderohet se paditësi ka kryer shkelje disiplinore të standardit 1, pikat 6, 7 dhe 14 të Kodit Disiplinor. Vendimi i mësipërm për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës është bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, Qendra e Paraburgimit në Lipjan administrohej nga Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut.

20. Më 13 korrik 2004, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit kundër vendimit të lartpërmendur të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

21. Më 26 janar 2005, organi i shkallës së dytë të punëdhënësit e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Vendimi i organit të shkallës së dytë të punëdhënësit, bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, i nënshkruar nga Kryetari i Bordit për Ankesa, nuk përmbante këshillë juridike.

22. Më 2 shkurt 2005, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale), duke kërkuar anulimin e vendimit të punëdhënësit të 26 qershorit 2004 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe vendimit të 26 janarit 2005 të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit për refuzimin e ankesës së tij.

23. Më 7 prill 2005, Gjykata Komunale, me Aktgjykimin [C. nr. 26/2005]: i) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit; (ii) anuloi vendimet e mësipërme të punëdhënësit të 26 qershorit 2004 dhe 26 janarit 2005; dhe (iii) obligoi punëdhënësin ta kthejë parashtruesin e kërkesës në pozitën e tij të mëparshme, duke i njohur të gjitha të drejtat e tij sipas kësaj marrëdhënie pune, duke filluar nga 30 qershori 2004 deri në kthimin e tij në vendin e tij të mëparshëm të punës.

24. Më 12 korrik 2005, punëdhënësi parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të mësipërm të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut).

25. Më 29 gusht 2007, Gjykata e Qarkut, me Aktvendimin [Ac. nr. 822/2005], e miratoi ankesën e punëdhënësit si të bazuar dhe e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale C. nr.26/2005, të 7 prillit 2005, duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje. Gjykata e Qarkut konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka statusin e nëpunësit civil dhe në këtë kontest, Gjykata Komunale ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike. Gjykata e Qarkut më tej konstatoi se parashtruesi i kërkesës duhet të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në vijim: KPMK) kundër vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të 26 qershorit 2004

dhe vendimit të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit për refuzimin e ankesës së tij të 26 janarit 2005.

26. Më 25 shkurt 2010, Gjykata Komunale, në procedurën e përsëritur, me aktgjykimin [C. nr. 286/07] vendosi që: (i) ta pranojë padinë e parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) ta detyrojë punëdhënësin që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës, ashtu që t'ia njohë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.

27. Më 22 qershor 2010, kundër aktgjykimit të mësipërm të Gjykatës Komunale, punëdhënësi parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut.

28. Më 28 qershor 2013, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [CA. nr. 1859/2012] aprovoi ankesën e punëdhënësit, si të bazuar, dhe e prishi aktgjykimin e Gjykatës Komunale C. nr. 286/2007 të 25 shkurtit 2010, duke e kthyer çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë, gjegjësisht nuk ka konstatuar nëse parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë në KPMK dhe në këtë mënyrë nuk ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike.

29. Më 30 korrik 2015, Gjykata Themelore, në procedurën e përsëritur, me aktgjykimin [C. nr. 329/13] vendosi që: (i) ta aprovojë padinë e parashtruesit të kërkesës dhe t'i anulojë vendimet e 26 qershorit 2004 dhe 26 janarit 2005 të punëdhënësit; dhe (ii) ta detyrojë punëdhënësin që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës duke ia njohur të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës.

30. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, përkatësisht ankesës në KPMK kundër vendimit të punëdhënësit, Gjykata Themelore arsyetoi *"[...] Në procedurë të përsëritur gjykata ka vlerësuar udhëzimet e gjykatës së shkallës së dytë nga vendimi nr. 02/344/2007 të 10 dhjetorit 2007 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, konstatoi se ky bord nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesave të zyrtarëve korrektues sepse gjatë vitit 2004, Bordi nuk ka pasur juridiksion të shqyrtojë ankesat e zyrtarëve korrektues sepse ky shërbim ka qenë nën juridiksionin e UNMIK-ut.. Për këto arsye paditësi nuk i është drejtuar fare KPMK-së, por lëndën e ka dorëzuar drejtpërdrejt në gjykatë, në mungesë të kompetencës së Këshillit. (Rasti i ngjajshëm i z. Kamber Hoxha, Oficer në Qendrën Korrektuese në Lipjan).".*

31. Më 1 dhjetor 2015, punëdhënësi parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të mësipërm të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit.

32. Më 16.04.2020, Gjykata e Apelit, me aktvendimin [Ac. nr. 725/16]:: (i) aprovoi ankesën e punëdhënësit si të bazuar; (ii) anuloi aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 329/13, të 30 korrikut 2015, dhe (iii) refuzoi padinë e parashtruesit si të paafatshme.

33. Më 30 qershor 2020, kundër aktvendimit [Ac. nr. 725/16] të 16 prillit 2020 të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën

Supreme për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që aktvendimi i Gjykatës së Apelit të anulohet dhe të vërtetohet aktvendimi i shkallës së parë, përkatësisht aktgjykimi [C. nr. 329/13] i 30 korrikut 2015 i Gjykatës Themelore. Në revizionin e tij, parashtruesi i kërkesës lidhur me konstatimin e Gjykatës së Apelit se kërkesa e tij është dorëzuar në Gjykatën Komunale, ndër të tjera, ka specifikuar se *„çështja e parashtrimit së padisë është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin C. nr. 26/2005 të 7 prillit 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin AC. nr. 286/2005 të 29 gushtit 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin AC. nr. 822/2007 të 25.02.2010 si dhe Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan me aktgjykimin C. nr. 170/14 të 03.03.2016, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin Ac. nr. 1580/2012 të 07.03.2014, Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin Rev. nr. 270/2014 të 6 janarit 2015, ku parashtrues i kërkesës është Kamber Hoxha, kolegji shqyrtues si dhe një numër i madh i gjyqtarëve të të gjitha instancave, kanë shqyrtuar këtë rast dhe të gjithë kanë vlerësuar se padia është e afatshme, ndërsa kolegji aktual pas dekadash ka konstatuar se padia është e paafatshme".*

34. Më 13 janar 2021, Gjykata Supreme, me aktgjykimin [Rev. nr. 387/2020], refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar.

35. Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e Apelit *"me aktgjykimin e saj jep arsye të mjaftuara dhe bindëse për marrjen e një vendimi të drejtë e të ligjshëm, të cilat janë të pranuara edhe nga kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar drejt se padia e paditësit për anulimin e vendimit dhe kthimin në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës është e pasafatshme pasi që paditësi ankesën kundër vendimit të organit të shkallës së parë të paditurës të datës 26.06.204 e ka paraqitur me datën 13.07.2004, ndërsa organi i shkallës së dytë të paditurës ka vendosur më datën 26.01.2005 ndërsa pasinë paditësi e ka paraqitur më 02.02.2005 dhe se fakti se organi i shkallës së dytë të paditurës ka vendosur jashtë afateve ligjore, nuk mund të shtyn afatet e parapara me ligj për paraqitjen e padisë, e kjo është 30 ditë pas paraqitjes së ankesës , e nëse nuk vendoset me ankesë atëherë në afatin e ardhshëm prej 15 ditëve duhet ta paraqesë padinë, prandaj thëniet e revizionit se padia është paraqitur në afat ligjor nuk qëndrojnë".*

36. Gjykata Supreme konstatoi që *"Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 67.1.6 të Ligjit të punës 03/L-212 ku është përcaktuar se një prej arsyeve për shkëputjen e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore është nëse i punësuari shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se 6 muaj dhe pasi që ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit është bërë për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës sipas nenit 11.3 dhe se procedurat janë zhvilluar në bazë të nenit 11.5 të Ligjit të punës Rregullorja nr. 2001/27 e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë shkelja e detyrave të punës nga ana e paditësit. Paditësi në revizion pretendon se nuk është zhvilluar procedura disiplinore ndaj paditësit çka nuk qëndron nga arsyeja se, siç u tha më lartë e paditura si punëdhënës, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka zbatuar dispozitat e nenit 11.5 të Ligjit themelor të punës ku paraprakisht është dorëzuar*

njoftimi me shkrim çka ekziston prova se paditësi është njoftuar, pasi që fletë dorëzimi është në shkresat e lëndës dhe se të njëjtit i është dorëzuar njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës çka për këtë ekziston edhe prova në shkresat e lëndës, prandaj edhe pretendimet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Afati i përcaktuar sipas dispozitës së nenit 83 paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës (Aprovuar nga Kuvendi i RSFJ me datën 28.9.1989) i aplikueshëm në kohën kur është krijuar raporti juridik, është afat prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta për mbrojtje gjyqësore, thëniet e revizionit se paditësi ka paraqitur padinë në afat ligjor, pas pranimit të vendimit të shkallës së dytë nuk qëndrojnë, nga fakti se vendosja lidhur me ankesën e paditësit pas afatit ligjor nuk i rivendos afatet ligjore".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

38. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me vendimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme thekson: *"Të dy gjykatat, e shkallës së dytë dhe të tretë kanë shkelur të drejtën e ushtrimit të padisë, duke i mohuar të drejtën për padi, sepse organi i shkallës së dytë i të padituri i ka dhënë udhëzimin juridik që pas pranimit të vendimit të shkallës së dytë paditësi ka të drejtë që të ushtroj padi në gjykata. Paditësi në afatin e caktuar ka ushtruar padi sipas këshillës juridike që ju është dhënë. Organi i shkallës së dytë ka vendosur më 26.01.2005 ndërsa padia është ushtruar më 02.02.2005, pra pas pesë ditësh, në afatin që është dhënë me vendimin e shkallës së dytë. Këtu ka të bëjë me shkelje të nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtetutës së Kosovës".*

39. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson, *"Me dhënien e këshillës juridike nga organi i shkallës së dytë që në afat prej 30 ditësh paditësi ka të drejtë të ushtroj padi në gjykatë, atëherë afati i kërkuar për ushtrimin e padisë 15 + 30 ditë nuk mund të zbatohet kur i jepet afati shtesë nga organi i shkallës së dytë".*

40. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që,*"Gjykata Kushtetuese e Kosovës të aprovoj kërkesën e Muhamet Ademit dhe të prishë aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 387/2020 të datës 13.01.2021 dhe lënda të vendoset si ne aktgjykimin C. nr. 329/13 të datës 30.06.2015".*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me lig.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë".

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren nr. 2000/59

"Neni 1
Ligji në fuqi

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

(b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në [...]".

Ligji për të drejtat themelore nga punësimi i 28 shtatorit 1989, RSFJ

"Nëse punëmarrësi nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent ose nëse ky organ nuk merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka të drejte të kërkoj mbrotte të të drejtave të tij në gjykatën kompetente."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe të specifikuara në Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

43. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 47
> (Kërkesa individuale)
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
> *2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*
>
> Neni 48
> (Saktësimi i kërkesës)
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
>
> Neni 49
> (Afatet)
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".*

44. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 387/2020] të 13 janarit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të

Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

45. Gjykata gjithashtu përcakton nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

46. Në fund, Gjykata konsideron se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe, rrjedhimisht duhet të shpallet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

47. Gjykata rikujton se, më 26 qershor 2004 punëdhënësi i parashtruesit të kërkesës vendosi ta ndërpresë marrëdhënien e tij të punës për shkak të shkeljes disiplinore gjatë orarit të punës. Prandaj, më 13 korrik 2004, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e punës së tij në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit. Më 26 janar 2005, përkatësisht më pas më shumë se 6 (gjashtë) muaj, organi i shkallës së dytë e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Si rezultat i vendimit të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale, duke kërkuar që të anulohet vendimi i punëdhënësit i 26 qershorit 2004 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjykata Komunale, me aktgjykimin [C. nr. 26/2005] të 7 prillit 2005: (i) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi vendimet e lartcekura të 26 qershorit 2004 dhe 26 janarit 2005 të punëdhënësit; i (iii) obligoi punëdhënësin që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës duke ia njohur të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo marrëdhënie e punës, duke filluar nga 30 qershori 2004 deri në kthimin e tij në vendin e tij të mëparshëm të punës. Si rezultat i ankesës së punëdhënësit kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Gjykata e Qarkut me Aktvendimin [Ac. nr. 822/2005] të 29 gushtit 2007, miratoi ankesën e punëdhënësit si të bazuar dhe e ktheu çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, duke konstatuar se parashtruesi kishte statusin e nëpunësit civil dhe për këtë arsye, ai ishte i detyruar të parashtronte ankesë në KPMK, si organ i shkallës së dytë. Nga shkresat e lëndës, rezulton se çështja e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës është kthyer për rigjykim në Gjykatën Komunale dhe se kjo e fundit me in [C. nr. 286/07] të 25 shkurtit 2010, miratoi kërkesëpadinë e e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi ta kthejë këtë të fundit në vendin e mëparshëm të punës. Si rezultat i ankesës së parashtruar nga punëdhënësi, Gjykata e Apelit, me aktgjykimin [CA. nr. 1859/2012] të 28 qershorit 2013 e vërtetoi ankesën e këtij të fundit dhe e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 25 shkurtit 2010. Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht nuk ka vërtetuar nëse parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë në KPMK, dhe rrjedhimisht nuk e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike. Pas kësaj, Gjykata Themelore në procedurën e përsëritur, me aktgjykimin [C. nr. 329/13] e 30 korrikut 2015: (i) miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi vendimet e punëdhënësit

të 26 qershorit 2004 dhe 26 janarit 2005; dhe (iii) obligoi punëdhënësin ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e mëparshëm të punës, duke ia njohur të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo marrëdhënie pune. Lidhur me rekomandimin e Gjykatës së Apelit përkitazi me procedurën e ankesës në KPMK, Gjykata Themelore konstatoi se KPMK-ja nuk ishte kompetente për t'i shqyrtuar ankesat e zyrtarëve korrektues sepse gjatë vitit 2004, KPMK-ja nuk kishte juridiksion për t'i shqyrtuar ankesat e zyrtarëve korrektues sepse ky shërbim ishte nën juridiksionin e UNMIK-ut. Si rezultat i ankesës së parashtruar nga punëdhënësi, Gjykata e Apelit, me aktvendimin [Ac. nr. 725/2016] të 16 prillit 2020, (i) aprovoi ankesën e punëdhënësit, si të bazuar; (ii) anuloi aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 329/13, të 30 korrikut 2015, dhe (iii) pasi konstatoi se padia e parashtruesit të kërkesës nuk është në pajtim me nenin 391 (f) të LPK-së, ishte e paafatshme. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme dhe kjo e fundit me Aktgjykimin [Rev. nr. 387/2020] të 13 janarit 2021, e refuzoi revizionin e tij, si të pabazuar. Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi i kërkesës e parashtroi padinë e tij të 2 shkurtit 2005 në Gjykatën Komunale kundër vendimit të shkallës së dytë të punëdhënësit të 26 janarit 2005 të dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP-së. Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi se LDTHMP ishte ligj në fuqi në kohën kur parashtruesi i kërkesës e kishte themeluar marrëdhënien e tij të punës me punëdhënësin dhe sipas dispozitës së mësipërme të këtij ligji, afati i përcaktuar në këtë dispozitë, përkatësisht paragrafi 1 i nenit 83 të LDTHMP-së *"i aplikueshëm në kohën kur është krijuar raporti juridik, është afati prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta për mbrojtje gjyqësore, thëniet e revizionit se paditësi ka paraqitur padinë në afat ligjor, pas pranimit të vendimit të shkallës së dytë nuk qëndrojnë, nga fakti se vendosja lidhur me ankesën e paditësit pas afatit ligjor nuk i rivendos afatet ligjore"*.

48. Parashtruesi i kërkesës konteston konkluzionet e mësipërme të aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës saktëson se *"Të dy gjykatat, e shkallës së dytë dhe të tretë kanë shkelur të drejtën e ushtrimit të padisë, duke i mohuar të drejtën për padi, sepse organi i shkallës së dytë i të paditurit i ka dhënë udhëzimin juridik që pas pranimit të vendimit të shkallës së dytë paditësi ka të drejtë që të ushtroj padi në gjykata. Paditësi në afatin e caktuar ka ushtruar padi sipas këshillës juridike që ju është dhënë. Organi i shkallës së dytë ka vendosur më 26.01.2005 ndërsa padia është ushtruar më 02.02.2005, pra pas pesë ditësh, në afatin që është dhënë me vendimin e shkallës së dytë. Këtu ka të bëjë me shkelje të nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtetutës së Kosovës"*. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës saktëson se mospranimi i afatit për padi nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme përbën shkelje të së drejtës së tij për ankesë.

49. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së. Megjithatë, Gjykata, bazuar në rrethanat faktike dhe juridike të rastit, vëren se krahas pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 54 të Kushtetutës,

pretendime të cilat parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur në kërkesë përmbajnë elemente të së drejtës për "qasje në gjykatë" si pjesë integrale e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

50. Në procedurën e shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës brenda fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), thekson se nuk është e kushtëzuar nga karakterizimi i shkeljeve që pretendon parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juria novit curia*, Gjykata është vetë përgjegjëse për karakterizimin e çështjeve kushtetuese që mund t'i përmbajë një rast i veçantë dhe mund të shqyrtojë vullnetarisht ankesat përkatëse, bazuar në dispozita ose qëndrime që nuk thirren shprehimisht nga palët (shih, në këtë drejtim, rasti Gjykatës: KI48/18, parashtrues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 81).

51. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ankesa karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih rasti i GJEDNJ-së: *Talpis kundër Italisë*, aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).

52. Prandaj, Gjykata do të vazhdojë t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në bazë të të cilave Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar si në vijim: *„Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

53. Në këtë drejtim, Gjykata së pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih rastet e Gjykatës KI62/17, parashtruese: *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018; paragrafi 41 dhe KI20/21 parashtruese: *Violeta Todorović*, aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 38; shih gjithashtu, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 tetorit 1988, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do t'u përmbahet këtyre parimeve.

54. Në lidhje me këtë dhe për të shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata do të shtjellojë parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën e "qasjes në gjykatë", e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në masën që lidhet me rrethanat e këtij rasti, për të vlerësuar aplikueshmërinë e këtyre neneve, në mënyrë që të vazhdojë me aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e këtij rasti.

I. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për "qasje në gjykatë" të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe praktika përkatëse ligjore

(i) Parimet e përgjithshme

55. Përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë", e drejtë e garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht vëren se ajo tashmë ka praktikë gjyqësore të ndërtuar mbi parimet e vendosura nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë, por pa u kufizuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 21 shkurtit 1975; *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, aktgjykim i 12 nëntorit 2002; *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, aktgjykim i 25 janarit 2000; dhe *Nait-Liman kundër Zvicrës*, aktgjykim i 15 marsit 2018). Megjithatë, rastet gjyqësore në të cilat Gjykata mbështeti parimet e vendosura nga GJEDNJ dhe i zbatoi ato në rastet përpara saj, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në rastet KI54/21, me parashtrues *Kamber Hoxha*, [aktgjykim i 4 nëntorit 2021]; KI62/17, me parashtrues *Emine Simnica* [aktgjykim i 29 majit 2018]; KI224/19, parashtrues *Islam Krasniqi* [Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020] dhe KI20/21 me parashtrues *Violeta Todorović* [Aktgjykim i 13 prillit 2021].

56. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rastit *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ku theksohet se *„e drejta e qasjes në gjykatë përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6 paragrafi. 1. Neni 6 para. 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen përfshin "të drejtën për një gjykatë", nga e cila e drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt të kësaj të drejte"* (shih rastin e GJEDNJ *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, cituar më lart, paragrafët 28-36).

57. Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore, respektivisht rastit KI54/21, me parashtrues *Kamber Hoxha,* ku është theksuar që *"interpretimi tejet formalist dhe konstatimi në lidhje me aplikueshmërinë e paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së në rrethanat e parashtruesit të kërkesës dhe konstatimi i tyre se kërkesëpadia e tij është e pasafatshme përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme në rrethanat e parashtruesit të kërkesës nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike; (ii) si rezultat i këtij interpretimi dhe konstatimi të Gjykatës Supreme, përmes Aktvendimit të saj të kontestuar parashtruesit të kërkesës i është mohuar "e drejta e tij e qasjes në gjykatë" në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së duke i pamundësuar atij që rasti i tij të vazhdojë të shqyrtohet në meritat e kërkesës"* (shih KI54/21, me parashtrues *Kamber Hoxha,* cituar më lart, paragraf 92).

58. Gjykata në këtë kontekst thekson se e "drejta në gjykatë", si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, përcakton që palët në

procedurë duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e lartcekura të Gjykatës KI54/21, me parashtruesin e lartpërmendur *Kamber Hoxha,* paragrafi 62; KI224/19, me parashtruesin e lartpërmendur *Islam Krasniqi,* paragrafi 35; dhe KI20/21, me parashtruesen e lartcekur *Violeta Todorović,* paragrafi 41, shih në këtë kontekst dhe rastet e lartcekura të GJEDNJ-së, *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* paragrafi 49, dhe rastin e lartcekur *Naït-Liman kundër Zvicrës,* paragrafi 112).

59. Gjykata më tej thekson se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim (shih në lidhje me këtë rastin e lartcekur të Gjykatës KI54/21, me parashtruesin e lartpërmendur *Kamber Hoxha,* paragrafi 64; KI20/21, me parashtruese *Violeta Todorović,* paragrafi 44).

60. Megjithatë, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i "*së drejtës në gjykatë*". Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastin e lartcekur të Gjykatës KI 20/21, me parashtruese *Violeta Todorović,* paragrafi 45, dhe rastet e GJEDNJ-së: *Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë,* Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15, dhe *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke,* Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61).

(ii) praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

61. Gjykata, bazuar në rrethanat e rastit konkret, i referohet edhe praktikës gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së, e cila i referohet të drejtës së qasjes në gjykatë, nga pikëpamja e garantimit të parimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të drejtë të drejtësisë, si parime themelore të shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike.

62. Në praktikën e saj gjyqësore, GJEDNJ-ja specifikoi se rregullat që përcaktojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë dhe afatet kohore që duhet të respektohen në paraqitjen e ankesës synojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe duhet të konsiderohen në përputhje me këtë, dhe në veçanti me parimet e sigurisë juridike (shih *Canete de Goni kundër Spanjës,* aktgjykim i 15 tetorit 2002, paragrafi 36). Në lidhje me këtë, GJEDNJ specifikoi se rregullat përkatëse ose zbatimi i tyre nuk duhet t'i pengojnë palët në procedurë të përdorin mjetin juridik në dispozicion (shih në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës,* aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafi 36). GJEDNJ-ja theksoi më tej se çdo rast duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në atë rast (shih *Kurşun kundër Turqisë,* aktgjykim i 30 tetorit 2018, paragrafët 103-104). Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja nënvizoi më tej se në zbatimin e rregullave procedurale, gjykatat duhet të shmangin edhe formalizmin e tepruar që do të përjashtonte një gjykim të drejtë dhe fleksibilitet të tepruar që do të zhvlerësonte kriteret

procedurale të përcaktuara me ligj (shih *Hasan Tunç dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykim i 31 janarit 2017, paragrafët 32-33).

63. Në mënyrë koncize, GJEDNJ në rastin *Zubac kundër Kroacisë* theksoi se *„respektimi i rregullave formale në procedurën civile [...] ka një vlerë dhe rëndësi të tillë, saqë ndalon arbitraritetin dhe siguron vendimmarrje efektive për kontestet dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe siguron siguri juridike dhe respekt për gjykatën"* (shih rastin *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 96). Në këtë rast, GJEDNJ nënvizoi gjithashtu *"megjithatë, e drejta e qasjes në gjykatë konsiderohet se është shkelur kur rregullat pushojnë së qeni në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe si rrjedhojë krijojnë një pengesë që i ndalon palët në procedurë që të gjykohen nga gjykata kompetente në themel* (paragrafi 98 i aktgjykimit në rastin *Zubac kundër Kroacisë*). Në kontekstin e kësaj të fundit, GJEDNJ-ja vlerësoi se në rastet kur autoritetet publike dhanë informata të pasakta ose të paplota, gjykatat vendore duhet të marrin parasysh mjaftueshëm rrethanat specifike të rastit në mënyrë që të mos zbatojnë rregullat dhe t'i praktikojnë ato në mënyrë shumë të ashpër (shih, në këtë drejtim rasti i GJEDNJ-së *Clavien kundër Zvicrës*, aktgjykim i 12 shtatorit 2017, paragrafi 27 dhe *Gajtani kundër Zvicrës*, aktgjykimi i 9 shtatorit 2014, paragrafi 75).

64. Nga ana tjetër, GJEDNJ në rastin *Ivanov dhe Ivashov kundër Rusisë* [aktgjykim i 26 janarit 2017] konstatoi se gjykatat vendase nuk duhet ta interpretojnë ligjin në mënyrë jofleksibile, duke çuar në vendosjen e një detyrimi që është i pamundur për palët ndërgjyqëse për të respektuar. Sipas GJEDNJ-së, një kërkesë për parashtrim të ankesës brenda një muaji nga data në të cilën zyrat e regjistrimit përpiluan një kopje të plotë të vendimit të gjykatës - në vend të datës në të cilën paditësi u njoftua për vendimin - çoi në skadimin e afatit të ankesës është varur nga faktori i cili është plotësisht jashtë kontrollit të paditësit. Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja konstatoi se e drejta për ankesë duhet të vlejë që nga dita kur paditësi është njoftuar me tekstin e plotë të vendimit. Në rastin konkret, GJEDNJ arriti në përfundimin se veprimi kontestues nuk ishte në proporcion me qëllimin për të garantuar sigurinë juridike dhe administrimin e duhur të drejtësisë, dhe për këtë arsye konstatoi se e drejta e tij për qasje në gjykatë garantohet me nenin 6 paragrafi 1 i GJEDNJ-së (shih paragrafët 52-58 aktgjykimet rastin në *Ivanov dhe Ivashov kundër Rusisë*).

(iii) Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën e qasjes në gjykatë

65. Gjykata, siç u përmend më lart, ka zbatuar parimet e mësipërme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në praktikën e saj gjyqësore. Konkretisht, Gjykata, siç u theksua më lart, iu referua tri rasteve të Gjykatës, përkatësisht rastit KI 62/17, me parashtrues *Emine Simnica*, KI 224/19 me parashtrues *Islam Krasniqi* dhe KI 20/21 me parashtrues *Violeta Todorović*, në të cilat në disa raste Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

66. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rastit të fundit të vendosur nga kjo Gjykatë, me ç'rast kjo e fundit, duke u thirrur dhe zbatuar parimet e mësipërme të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstatoi shkelje të së drejtës së qasjes në gjykatë, si një nga parimet e një gjykimi të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës në rastin KI54/21 ndërlidhen me një vendim të vitit 2004 të punëdhënësit, përkatësisht Shërbimit korrektues, Qendra e Paraburgimit në Lipjan, për shkëputjen e marrëdhënies së punës si rezultat i shkeljes disiplinore gjatë orarit të punës. Parashtruesi i kërkesës, fillimisht kishte kontestuar këtë vendim në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit, i cili pas 6 (gjashtë) muajsh më vonë, kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës kishte filluar procedurat para gjykatave të rregullta. Gjykata Komunale në Lipjan, kishte vendosur në favor të parashtruesit përkatës, duke e detyruar punëdhënësin që të njëjtin ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës, duke i njohur atij të gjitha të drejtat që dalin nga kjo marrëdhënie e punës. Megjithatë, si rezultat i ankesës së punëdhënësit, procedura lidhur me kërkesëpadinë e tij gjatë periudhës të vitit 2006 deri në vitin 2015, procedura ishin zhvilluar në Gjykatën e Qarkut, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, në të cilat kjo kërkesëpadi ishte shqyrtuar si nga aspekti procedural dhe ai i meritave të kërkesëpadisë. Përfundimisht, çështja ishte kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore, dhe e cila, sërish kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, dhe duke vendosur sipas ankesës së punëdhënësit, Gjykata e Apelit, kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, kësaj radhe duke konstatuar se padia fillestar ishte paraqitur jashtë afateve ligjore siç është përcaktuar në Ligjit për të Drejtat Themelore të Marrëdhënies së Punës të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së. Duke vepruar sipas kërkesës për revizion, Gjykata e Supreme konfirmoi qëndrimin e Gjykatës së Apelit. Si rezultat, Gjykata Kushtetuese konteston aktgjykimin i kontestuar i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe rrjedhimisht, shpalli të njëjtin të pavlefshëm duke e kthyer në rivendosje në pajtueshmëri me konstatimet e Gjykatës Kushtetuese.

II. Zbatimi i parimeve të mësipërme në rrethanat e këtij rasti

67. Gjykata rikujton se më 13 korrik 2004, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në organin e shkallës së dytë të punëdhënësit kundër vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të 26 qershorit 2004. Më 26 janar 2005, ose pas më shumë se gjashtë (6) muaj, organi i shkallës së dytë ka nxjerrë vendimin me të cilin refuzon ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe si rezultat i vendimit të organit të shkallës së dytë të punëdhënësit, parashtruesi ka paraqitur brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve padi në Gjykatën Komunale, përmes të cilit kërkoi anulimin e vendimit të punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij më 26 qershor

2004. Në këtë rast, gjykata thekson se vendimi i organit të shkallës së dytë i punëdhënësit nuk përmban këshillë juridike lidhur me mjetet juridike. Përveç kësaj, Gjykata vëren se baza ligjore për nxjerrje të këtij vendimi, e përmendur në preambulën e këtij vendimi, ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil. Si pasojë e padisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale, duke e shqyrtuar kërkesëpadinë në merita, me Aktgjykimin C. nr. 26/2005, të 7 prillit 2005, vërtetoi kërkesëpadinë e tij me të cilin e obligoi punëdhënësin që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës. Nga momenti i paraqitjes së ankesës kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës Komunale nga punëdhënësi në Gjykatën e Qarkut, gjegjësisht të 2005 deri në miratimin e vendimit të kontestuar [Ac. nr. 725/16] të 16 prillit 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimeve [Rev. nr. 387/2020] të 13 janarit 2021 të Gjykatës Supreme, çështja e padisë së parashtruesit të kërkesës, e shtjelluar në detaje, për pesëmbëdhjetë (15) vjet është trajtuar pranë gjykatave të rregullta si në aspektin e pranueshmërisë ashtu edhe në aspektin e bazueshmërisë së padisë.

68. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në kronologjinë procedurale të këtij rasti në gjykatat e rregullta, dhe në aspektin e "të drejtës së qasjes" në gjykatë, vëren se parashtruesi i kërkesës ka pasur qasje në gjykatë gjatë kësaj periudhe, deri te nxjerrja e vendimit [Ac. nr. 725/16] të 16 prillit 2020, të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit është vendosur që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të hidhet poshtë si e paafatshme. Gjithashtu, Gjykata Supreme, duke refuzuar revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, sepse konstatoi se në bazë të nenit 83, paragrafi 1 i LDTHMP-së të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së, vërtetoi se kërkesa e tij ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me këtë dispozitë, dhe kështu vërtetoi përfundimin e Gjykatës së Apelit me vendimin e mësipërm, të 16 prillit 2020.

69. Gjykata rithekson se arsyeja kryesore për refuzimin e padisë së parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës së Apelit, përkatësisht nga Gjykata Supreme ishte se këto të fundit duke interpretuar dhe zbatuar nenin 83 paragrafi 1 të LDTHMP-së të 28 shtatorit 198 të RSFJ-së kanë ardhur në përfundim se kërkesa e tij është paraqitur jashtë afatit të paraparë me këtë dispozitë. Sipas interpretimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës është dashur të parashtrojë padi në Gjykatën Komunale në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas skadimit të tridhjetë (30) ditëve nga data e parashtrimit të ankesës në organin e shkallës së dytë.

70. Duke thënë këtë, Gjykata rikujton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës: (i) organi i shkallës së dytë të punëdhënësit nuk ka nxjerrë aktvendim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e ankesës së parashtruesit kundër aktvendimit të punëdhënësit për ndërprerje të marrëdhënies së punës të parashtruesit të 26 qershorit 2004; (ii) por nxori vendimin më 26 janar 2005, përkatësisht gjashtë (6) muaj pas parashtrimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës pranë këtij organi; dhe (iii) parashtruesi i kërkesës ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale kundër këtij vendimi të shkallës së dytë, të marrë më 26 janar 2005, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, përkatësisht më 2 shkurt 2005.

71. Duke pasur parasysh këtë, mbetet për t'u përcaktuar nëse aktvendimi [Ac. nr. 725/16] i 16 prillit 2020 i Gjykatës së Apelit dhe aktgjykimi [Rev. nr. 387/2020] i 13 janarit 2021 i Gjykatës Supreme, përmes të cilit u konstatua se padia ishte e paafatshme dhe se parashtruesit të kërkesës praktikisht iu mohua "e drejta për qasje në gjykatë" nga pikëpamja e sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, si dhe garancitë e përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim dhe bazuar në rrethanat e këtij rasti, Gjykata do të vlerësojë nëse (i) interpretimi dhe zbatimi i paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme për hedhjen poshtë të padisë së parashtruesit të kërkesës pas pesëmbëdhjetë (15) viteve të zhvillimit të procedurës kontestimore, në lidhje me kërkesëpadinë e tij në këtë rast ka shkelur të drejtën e tij për qasje në gjykatë dhe si pasojë (ii) e ka penguar parashtruesin e kërkesës të vazhdojë rastin e tij në merita të kërkesës.

72. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet konkluzioneve të GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, duke theksuar, ndër të tjera,: (i) rregullat që përcaktojnë kriteret formale që duhen respektuar dhe afatet kohore që duhet të respektohen në paraqitjen e ankesës synojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe duhet të shqyrtohen në veçanti me parimet e sigurisë juridike (shih *Canete de Goni kundër Spanjës*, aktgjykim i 15 tetorit 2002, paragrafi 36); (ii) rregullat përkatëse ose zbatimi i tyre nuk duhet t'i pengojnë palët në procedurë të përdorin mjetin juridik në dispozicion (shih në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafi 36); (iii) çdo rast duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në atë rast (shih *Kurşun kundër Turqisë,* aktgjykim i 30 tetorit 2018, paragrafët 103 – 104); (iv) gjykatat duhet të shmangin edhe formalizmin e tepruar që do të përjashtonte një gjykim të drejtë dhe fleksibilitet të tepruar që do të zhvlerësonte kriteret procedurale të përcaktuara me ligj (shih *Hasan Tunç dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykim i 31 janarit 2017, paragrafët 32 – 33).

73. Prandaj, Gjykata, bazuar në pikëpamjet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, do të vlerësojë nëse Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nga pikëpamja e administrimit të drejtë të drejtësisë dhe respektimit të parimit të sigurisë juridike gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore, përkatësisht neni 83 i LDTHMP-së lidhur me afatet kohore të padisë: (i) ka marrë për bazë rrethanat specifike të çështjes, përkatësisht rrethanat e procedurës së zhvilluar pranë gjykatave të rregullta, dhe në këtë drejtim (ii) nëse i është shmangur formalizmit të tepruar.

74. Gjykata, duke iu referuar fillimisht shkresave të lëndës, vëren se vendimi i punëdhënësit për ndërprerje të marrëdhënies s[punës më 26 qershor 2004 bazohet në Ligjin për Shërbimin Civil [Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36], dhe po ashtu vëren se vendimi i organit të shkallës së dytë, i cili po ashtu bazohet në këtë ligj, nuk përmban këshillë juridike. Për më tepër, gjatë procedurës pranë gjykatave të rregullta, për aq sa mund të konstatohet nga shkresat e lëndës, gjykatat e rregullta nuk kishin vërtetuar më parë se në rastin e parashtruesit të kërkesës ligj i aplikueshëm ishte LDTHMP. Konkluzioni i gjykatave të rregullta se ligji që zbatohet në rastin e parashtruesit të kërkesës

LDTHMP është dhënë për herë të parë përmes aktgjykimit [Rev. nr. 387/2020] të Gjykatës Supreme të 13 janarit 2021.

75. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet vendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 725/16] të 16 prillit 2020 përmes të cilit padia e parashtruesit të kërkesës është refuzuar si e paafatshme, pasi që është parashtruar pas afatit për paraqitjen e ankesës, dhe rrjedhimisht në rrethana të tilla, dispozita e nenit 391, pika (f) të LPK parashikon që: *„Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata, me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj".*

76. Në vijim, Gjykata rikujton gjithashtu përfundimin e Gjykatës Supreme të dhënë në aktgjykimin [Rev. nr. 387/2020] të 13 janarit 2021, përmes të cilit përcaktohet se Gjykata e Apelit kishte zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale *Afati i përcaktuar sipas dispozitës së nenit 83 paragrafi 1 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës (Aprovuar nga Kuvendi i RSFJ me datën 28.9.1989) i aplikueshëm në kohën kur është krijuar raporti juridik, është afat prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta për mbrojtje gjyqësore, thëniet e revizionit se paditësi ka paraqitur padinë në afat ligjor, pas pranimit të vendimit të shkallës së dytë nuk qëndrojnë, nga fakti se vendosja lidhur me ankesën e paditësit pas afatit ligjor nuk i rivendos afatet ligjore".* Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale më 2 shkurt 2005 kundër aktvendimit të shkallës së dytë të punëdhënësit të 26 janarit 2005 për shkak të faktit se organi i shkallës së dytë kishte vendosur jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh. Sipas Gjykatës Supreme, afati i referuar në paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP-së *"është afat prekluziv, me kalimin e afatit humbet e drejta për mbrojtje gjyqësore"* dhe rrjedhimisht ky afat nuk mund të rivendoset.

77. Lidhur me konkluzionet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, Gjykata thekson se nuk konteston dhe nuk vë në dyshim përmbajtjen e dispozitës ligjore përkatëse dhe konkluzionit të këtyre gjykatave në lidhje me zbatimin e atij ligji, i cili konkluzion i takon fushës së ligjshmërisë.

78. Përveç kësaj, sa i përket administrimit të duhur të drejtësisë, Gjykata thekson se zbatimi i rregullave formale dhe procedurale në lidhje me pranueshmërinë e çështjeve është i një rëndësie të tillë që i shërben sigurisë juridike në zhvillimin e procedurave gjyqësore në gjykatat e rregullta.

79. Megjithatë, siç interpretohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konsideron se kur interpretimi i rregullave procedurale rezulton në formalizëm të tepruar, atëherë ky interpretim pushon së qeni në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe për pasojë mund të rrezikojë qasjen në gjykatë të parashtruesit të kërkesës.

80. Në vijim, Gjykata dëshiron gjithashtu të theksojë se në rastet kur autoritetet publike kanë dhënë informatë të pasaktë ose të paplotë, gjykatat e rregullta gjatë interpretimit dhe zbatimit të rregullave formale dhe procedurale duhet ta

marrin parasysh mjaftueshëm këtë fakt ose rrethanat specifike në lidhje me zhvillimin e procedurës. Në kontekst të rastit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë nëse gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, i kanë marrë për bazë rrethanat specifike të rastit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht nëse kanë marrë për bazë faktin se Vendimi për ndërprerjen marrëdhënies së punës i 26 dhjetorit 2004 dhe vendimi i shkallës së dytë të punëdhënësit i 26 janarit 2005 bazohej në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil, ku vendimi i fundit nuk përmbante as kështillë juridike dhe (ii) procedura e cila është kryer gjatë pesëmbëdhjetë viteve, në të cilën procedurë rasti i parashtruesit të kërkesës është shqyrtuar si në aspektin procedural ashtu edhe në merita të rastit, por në të cilën procedurë deri në nxjerrjen e aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 16 prillit 2020, nuk është shqyrtuar çështja e afatit të kërkesëpadisë së tij.

81. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata, duke zbatuar pikëpamjet dhe konstatimet e GJEDNJ-së, vëren se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, gjatë interpretimit dhe zbatimit të nenit 83 paragrafi 1 të LDTHMP-së, nga pikëpamja e zbatimit së drejtësisë së vërtetë, është dashur që në rastin konkret të kenë parasysh: (i) rrethanat specifike të rastit të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht të merret parasysh fakti se Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i 26 qershorit 2004 dhe vendimi i organit të shkallës së dytë të punëdhënësit i 26 janarit 2005. ishin bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 dhe se vendimi i fundit nuk përmbante kështillë juridike; (ii) se procedura në gjykatat e rregullta ka zgjatur më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vjet nga parashtrimi i kërkesëpadisë së tij në Gjykatën Komunale dhe gjatë kësaj procedure rasti i tij është shqyrtuar si për pranueshmëri ashtu edhe për meritat e kërkesëpadisë.; (iii) se pranueshmëria e kësaj kërkese në aspektin kohor, përkatësisht zbatueshmërisë së LDTHMP-së nuk është iniciuar deri në nxjerrjen e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 725/2016] të 16 prillit 2020 dhe se çështja e zbatueshmërisë së LDTHMP-së nuk është përmendur gjatë procedurave gjyqësore të zhvilluara deri në nxjerrjen e aktvendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit; dhe si rezultat i kësaj të fundit (iv) të shmanget formalizmi i tepruar në interpretimin e dispozitës përkatëse të LDTHMP-së në rrethanat e parashtruesit të kërkesës.

82. Si rezultat i sa më sipër, Gjykata konstaton se si rezultat i interpretimit dhe zbatimit formalist të paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së, konstatimi i tyre në lidhje me afatin e kërkesëpadisë ka pushuar së qeni në shërbim të parimit të sigurisë juridike dhe rrjedhimisht është shkelur "e drejta e qasjes" në gjykatë e parashtruesit të kërkesës.

83. Përveç kësaj, Gjykata vëren se interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të LDTHMP-së të vitit 1989 nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme në rrethanat e parashtruesit të kërkesës nuk është në proporcion me qëllimin e ndjekur për siguri juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë, si një nga parimet themelore të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

84. Prandaj, në bazë të të lartcekurave, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duke interpretuar dhe zbatuar paragrafin 1 të nenit 83 të LDTHMP-së të vitit 1989, i kanë: (i) mohuar *"të drejtën e qasjes në gjykatë"*

brenda kuptimit të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) si rezultat, i pamundësuan atij që të vazhdojë të shqyrtojë çështjen e tij në merita të kërkesës.

85. Në fund, Gjykata konstaton se konkluzioni i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme përmes aktvendimeve të mësipërme, përmes të cilëve refuzohet kërkesëpadia e parashtruesit si e papranueshme, janë nxjerrë në kundërshtim me të drejtën e parashtruesit për qasje në gjykatë. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 725/2016] i 16 prillit 2020 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2020] i 13 janarit 2021 nuk janë në pajtim me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

86. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij gjithashtu pretendoi shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në këtë drejtim, siç u shtjellua më lart, Gjykata konstatoi se rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës përfshijnë elemente që lidhen me të drejtën e parashtruesit për qasje në gjykatë, si një nga parimet e garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe në vazhdim, pasi shtjelloi dhe shqyrtoi pretendimet e tij dhe procedurën e kryer në gjykatat e rregullta, konstatoi se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e tij për qasje në gjykatë. Prandaj, si rezultat i këtij përfundimi, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtojë në mënyrë të veçantë pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

Përfundim

87. Gjykata shqyrtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe përkundër faktit se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendoi edhe shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata konstatoi se rrethanat e këtij rasti përmbajnë elemente që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të së drejtës së tij për qasje në gjykatë, si një nga parimet e garantuara në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Në vijim, për të vlerësuar dhe shqyrtuar këtë pretendim, Gjykata, me qëllim të vlerësimit, ka zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës si dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në rrethanat e parashtruesit të kërkesës.

88. Gjykata, pas shtjellimit dhe shqyrtimit të procedurës së zhvilluar dhe arsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, përkatësisht Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, konstatoi se: (i) interpretimi i tepruar formalist dhe konstatimi mbi zbatueshmërinë e paragrafit 1 të nenit 83 të LDTHMP-së në rrethanat e parashtruesit të kërkesës dhe gjetja e tyre se kërkesëpadia e tij është e paafatshme përmes vendimeve të kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, nuk është në proporcion me qëllimin e ndjekur për të garantuar sigurinë juridike dhe administrimin e duhur të drejtësisë, si një nga parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike; (ii) se si rezultat i këtij interpretimi dhe gjetjeve Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme në

vendimet e tyre të kontestuara, parashtruesit të kërkesës i është mohuar "*e drejta për qasje në gjykatë*", brenda kuptimit të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së duke i pamundësuar atij që të vazhdojë me shqyrtimin e meritave të kërkesës në rastin e tij.

89. Në fund, Gjykata konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2020] i 13 janarit 2021, është nxjerrë në kundërshtim me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, e cila garantohet me nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

90. Përfundimisht, Gjykata, si rezultat i konkluzionit të saj për shkeljen e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 paragrafi 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, nuk e konsideroi të nevojshme që të shqyrtohen veçanërisht pretendimet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 mars 2022, njëzëri,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/ 2020] i 13 janarit 2021, nuk është në pajtim me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2020] të 13 janarit 2021;

IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 387/2020] të 13 janarit 2021, në rivendosje në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën, deri më 12 shtator 2022 për masat e ndërmarra me qëllim të zbatimit të aktgjykimit të kësaj Gjykate;

VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Nexhmi Rexhepi Gresa Caka-Nimani